

# **Karta e Këshillit të Evropës për EQD dhe EDNJ**

## **Memorandum shpjegues**

### **I. Sfondi, origjina dhe historia e marrëveshjeve që papraprinë Kartën**

1. Karta e Këshillit të Evropës për Edukimin për Qytetari Demokratike dhe për të Drejtat e Njeriut (Karta), e miratuar në kuadrin e Rekomandimit të Komitetit të Ministrave CM/Rec (2010)7, shënon një fazë të rëndësishme në punën e Këshillit të Evropës në këtë fushë.

Një shtysë të rëndësishme në këtë drejtim ka dhënë Samiti i 2<sup>-të</sup> i Kryetarëve të Shteteve dhe të Qeverive të Këshillit të Evropës, i mbajtur në Strasbourg në 10 dhe 11 tetor 1997, i cili vendosi:

të fillonte një program të veçantë të edukimit për qytetari demokratike, për të rritur vetëdijen e qytetarëve për të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre në një shoqëri demokratike (Deklarata Finale e Samitit të 2<sup>-të</sup> të Kryetarëve të Shteteve dhe të Qeverive të Këshillit të Evropës).

Ky vendim pasqyron vetëdijen në rritje për rolin e arsimit në zhvillimin e vlerave themelore të Këshillit të Evropës – demokracia, të drejtat e njeriut dhe shteti i së drejtës, si dhe në parandalimin e shkeljeve të të drejtave të njeriut. Për më tepër, arsimit po shihet gjithnjë e më shumë si një instrument mbrojtës kundrejt rritjes së dhunës, racizmit, ekstremizmit, ksenofobisë, diskriminimit dhe intolerancës. Po kështu, po pranohet gjerësisht ideja se arsimit luan rol të rëndësishëm edhe në forcimin e kohezionit shoqëror dhe të drejtësisë shoqërore. Vendimi i Samitit të 2<sup>-të</sup> i dha organizatës mandatin për të zhvilluar një numër programesh bashkëpunimi në fushën e edukimit për qytetari dhe për të drejtat e njeriut si në fushën e arsimit formal, ashtu edhe në atë joformal.

2. Vendimi i Samitit të 2<sup>-të</sup>, në nivel politik, u vu në zbatim përmes përgatitjes së Deklaratës dhe Programit të Veprimit të Edukimit për Qytetari Demokratike, i miratuar në takimin e Komitetit të Ministrave, të mbajtur më 7 maj 1999, në Budapest. Gjatë fazës së parë të projektit, nga viti 1997 deri në vitin 2000, sektorët e ndryshëm të Këshillit të Evropës punuan së bashku për të eksploruar përkufizimet, konceptet bazë, metodat, praktikat dhe materialet dhe për të mbështetur projektet në bazë ("qendrat e qytetarisë"). Në vitin 2000, rezultatet e fazës së parë të projektit u vlerësuan dhe u mbështetën nga ministrat e arsimit të mbledhur në Krakov. Ata konfirmuan vazhdimësinë e projektit dhe kërkuan përgatitjen e një rekomandimi të Komitetit të Ministrave për këtë qëllim.

3. Faza e dytë e projektit, nga viti 2001 në vitin 2004, përmban zhvillimet e politikave, ngritjen e një rrjeti të koordinatorëve të shteteve anëtare për edukimin për qytetari demokratike dhe përgatitjen e Vitit European të Qytetarisë përmes Edukimit (Viti), që do të mbahej në vitin 2005. Një zhvillim i rëndësishëm i kësaj faze është miratimi, në tetor të vitit 2002, nga Komiteti i Ministrave, i Rekomandimit Rec (2002)<sup>12</sup> për shtetet anëtare për edukimin për qytetari demokratike, si përgjigje e kërkesës së sipërpërmendur të ministrave të arsimit.

4. Viti i qytetarisë u mbajt me sukses në vitin 2005 dhe u shoqërua me një rritje të dukshme, në radhët e shteteve anëtare, të vetëdijes për vlerën e edukimit për qytetari demokratike dhe me rritjen e numrit të vendeve në të cilët ky edukim është pjesë e kurrikulës dhe e programeve të të nxënies gjatë gjithë jetës. Viti dhe konferenca për vlerësimin e tij, e mbajtur në Sinaia të Rumanisë, u ofruan shanse vendeve dhe organizatave joqeveritare të shkëmbejnë shembuj dhe praktika pozitive në këtë fushë.

5. Progresi, që u vu re dukshëm në politikat dhe praktikat e shteteve anëtare gjatë Vitit, dëshmoi se shtetet i kishin marrë parasysh rekomandimet, ndërkohë që Rekomandimi Rec (2002)<sup>12</sup>, që në fazat e para, bënte thirrje për hartimin e një dokumenti politik më të rëndësishëm në këtë fushë, i cili, mundësisht, të kishte një formë detyruese. Në tetor të vitit 2004, Asambleja Parlamentare rekomandoi hartimin, nga Komiteti i Ministrave (Rekomandimi i Asamblesë 1682 (2004) për arsimin në Europë), e një Konvente Europiane për Edukimin për Qytetari Demokratike dhe për të Drejtat e Njeriut. Në dhjetor të vitit 2004, Deklarata e Rotslaf (Wroclaw, Poloni) për 50-vjetorin e Bashkëpunimit Kulturor, e miratuar nga ministrat përgjegjës për kulturën, arsimin, rininë dhe sportet nga Shtetet Palë të Konventës Europiane për Kulturën (ETS No.18), shpallte që "Këshilli i Europës duhet të fuqizojë rolin e tij si një qendër cilësie për politikat që synojnë të pajisin njerëzit me njohuri, aftësi e qëndrime për të jetuar në shoqëritë demokratike... Për këtë qëllim i duhej kushtuar rëndësi vendosjes së standardeve europiane përmes krijimit të mekanizmave të përshtatshëm për këtë qëllim". Në Samitin e 3<sup>të</sup> të Kryetarëve të Shteteve dhe të Qeverive, të mbajtur në Varshavë në maj të viti 2005, kryetarët e shteteve bënë thirrje për "rritjen e përpjekjeve të Këshillit të Europës në fushën e edukimit për të siguruar kushtet për arsimimin e të gjithë të rinjve në Europë, për përmirësimin e cilësisë së tij dhe për të nxitur, përveç të tjerave, një edukim tërësor të të drejtave të njeriut". Në sesionin e 22<sup>të</sup> të Konferencës së Ministrave Europiane të Arsimit (Stamboll, maj 2007), Kryetari i Konferencës së Ministrave të Çështjeve të Arsimit dhe të Kulturës së Landerit, Gjermani, bëri të ditur qëndrimin se përgatitja e një dokumenti politik për edukimin për qytetari demokratike dhe për të drejtat e njeriut (EQD/EDNJ) nuk është në

interesin e Gjermanisë, për shkak të kushteve krejtësisht të ndryshme që ekzistojnë në shtetet anëtare. Megjithatë, Gjermania pranon se shumë vende mund të kenë nevojë për udhëzime nga Këshilli i Europës dhe, për këtë qëllim, mund të gjendet një kompromis i pranueshëm nga të gjithë.

6. Në të njëjtën kohë, zhvillime të ngjashme ndodhën edhe në fushën e politikës për rininë. Programi i Rinisë për Edukimin për të Drejtat e Njeriut, që filloi në vitin 2000, synonte "të shndërronte edukimin për të drejtat e njeriut në një faktor të përhershëm të politikës së rinisë dhe të praktikës së punës së saj". Në Konferencën e 7<sup>-të</sup> të Ministrave të Europës përgjegjës për Rininë, ministrat nxitën Këshillin e Europës të përgatiste draftin e një rekomandimi për Komitetin e Ministrave, drejtuar shteteve anëtare për edukimin e të drejtave të njeriut me të rinjtë, në të cilën të përfshiheshin edhe nene për fuqizimin e bashkëpunimit European në fushën e parandalimit të dhunës, duke u mbështetur edhe në përvojën e Programit të Rinisë për Edukimin e të Drejtave të Njeriut, të Këshillit të Europës. Komiteti i Ministrave, në rezolutën e tij (2008) 23, fuqizoi më tej rolin qendror të edukimit për të drejtat e njeriut në politikën e Këshillit të Europës për rininë, duke i përcaktuar të drejtat e njeriut dhe demokracinë si përparësi të kësaj politike, "për të garantuar realizimin e plotë të të rinjtë e të drejtave dhe të dinjitetit njerëzor, si dhe për të rritur edhe përkushtimin e tyre në këtë drejtim".

7. Një zhvillim i rëndësishëm politik në Këshillin e Europës ka qenë rritja e interesit për dialogun ndërkulturor. Sot, dialogu ndërkulturor trajtohet nga Këshilli i Europës, krahas fushave të tij parësore. Në mënyrë të veçantë, rëndësia e edukimit për qytetari demokratike dhe për të drejtat e njeriut për zhvillimin e dialogut ndërkulturor pranohet në "Letrën e Bardhë të Dialogut Ndërkulturor", të shpallur në vitin 2008<sup>1</sup>.

8. Zhvillimet globale ndjekin të njëjtën prirje, në mënyrë të veçantë në Kombet e Bashkuara (KB). Programi botëror për edukimin për të drejtat e njeriut, i miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në 10 dhjetor të vitit 2004, përmban objektiva ambiciozë për fuqizimin dhe zhvillimin e edukimit të të drejtave të njeriut. Ky program, në fazën e parë, do të realizohet në arsimin bazë të shteteve anëtare. Këshilli i Europës i ndihmon Kombet e Bashkuara me zbatimin e Programit Botëror për edukimin për të drejtat e njeriut në Europë, në kuadrin e një marrëveshjeje zyrtare me të.

9. Në përgjigje të këtyre zhvillimeve, në kohën kur Komiteti Drejtues i Këshillit të Europës për Arsimin miratoi programin e Këshillit për veprimtaritë

---

<sup>1</sup> "Letër e Bardhë për Dialogun Ndërkulturor: Të jetojmë së bashku si të barabartë në dinjitet", të shpallur nga Ministrat e Punëve të Jashtme të 47 shteteve anëtarë të Këshillit të Europës, në Sesionin e tyre të 118<sup>-të</sup> Ministerial (Strasbourg, 6-7 maj 2008).

në fushën e Edukimit për Qytetari Demokratike dhe për të Drejtat e Njeriut, për fazën e tretë të projektit (2006-2009), u hodh ideja dhe u krijuan kushtet për një “studim për mundësinë e një kuadri reference për edukimin për qytetari demokratike dhe për të drejtat e njeriut ( dhe mekanizmat përkatës)”. Termat e referencës për këtë studim kërkonin që ai të shqyrtonte nevojën për një dokument politik European në këtë fushë; të identifikonte dokumentet ekzistues të kësaj natyre dhe të mekanizmave përkatës në kuadrin e Këshillit të Europës dhe në atë të organizatave ndërkombëtare, duke identifikuar edhe boshllëqet dhe mangësitë; të sugjeronte, nga pikëpamja e vlerës së shtuar, një dokument të ri reference, si dhe formën dhe përmbajtjen e tij.

10. Një eksperti të posaçëm, iu caktua detyra të përgatiste studimin me ndihmën e një grupi ekspertësh nga vende të ndryshme të përbërë nga specialistë arsimi dhe përfaqësues të organizatave rinore. Studimi u dorëzua në prill të vitit 2007.

11. Studimi mori formën e një “dokumenti kuadër politik, domethënë, të një instrumenti ndërkombëtar (detyrues ose jodetyrues), për shtetet anëtare, cili përmbante standarde dhe politika të pranuar prej tyre për t’u zbatuar në fushën e edukimit për qytetari demokratike dhe për të drejtat e njeriut. Ai rishikoi fillesat e punës së Këshillit të Europës në fushën e edukimit për qytetari demokratike, të cilat i kanë rrënjët në vetë thelbin e Misionit të Organizatës për të zhvilluar të drejtat e njeriut, demokracinë dhe shtetin e së drejtës. Po kështu, ai vuri në dukje se praktika e vazhdueshme e Këshillit të Europës, në çdo fushë të interesit të përbashkët dhe të veprimit nga shtetet anëtare (të drejtat e njeriut, minoritetet kombëtare, politika sociale, kundërterrorizmi etj.), kanë çuar në forma të ndryshme, në dokumente kuadër politikë, që sigurojnë kahun e përqendrimit dhe të veprimit në nivel shteti dhe përhapjen e përvojave pozitive, duke rritur edhe standardet në nivel europian. Studimi rishikoi edhe instrumentet ekzistues, identifikoi boshllëqet dhe mangësitë, si dhe vlerën e krijimit të një instrumenti të ri. Ai shqyrtoi format e mundshme të këtij instrumenti, qoftë ai detyrues apo jo, si dhe alternativat e mundshme të përmbajtjes dhe të fushës së veprimit.

12. Në përfundimet e tij, studimi rekomandonte si të përshtatshëm marrjen e një vendimi për të kaluar në diskutime për përmbajtjen dhe formën e një dokumenti kuadër politik të ri në këtë fushë.

13. Gjatë viteve 2007 dhe 2008, studimi, fillimisht, u paraqit në Grupin Këshillimor Ad hoc për Edukimin për Qytetari Demokratike dhe për të Drejtat e Njeriut (ED-EDCHR) dhe, më pas, në organizma të tjerë të Këshillit të Europës,

të cilët dhanë edhe komentet e tyre për të: Komiteti Drejtues për të Drejtat e Njeriut (CDDH), Këshilli i Përbashkët për Rininë (JCY), Komiteti Drejtues për Arsimin e Lartë (CDESR), Byroja e Komitetit Drejtues për Arsimin (CDED). Të gjithë organizmat e konsultuar paraqitën opinionet e tyre me shkrim pranë Byrosë së Komitetit Drejtues për Arsimin, si organizmi me përgjegjësinë kryesore në fushën e arsimit. Mendimet e tyre për këtë studim pranë Byrosë së Komitetit Drejtues për Arsimin i dhanë edhe koordinаторët kombëtare të Shteteve Anëtare për Edukimin për Qytetari Demokratike dhe për të Drejtat e Njeriut.

14. Gjatë kësaj periudhe u vunë re të zhvilloheshin disa prirje idesh. Analizat e bëra në këtë studim për kuadrin politik dhe ligjor të situatës aktuale dhe të boshllëqeve e mangësive që viheshin re në dokumentet ekzistuese politike, gjetën mbështetje të gjerë. Mbështetje të tillë pati edhe ideja, që vijoi si përfundim i analizave të bëra, se hartimi i një dokument të ri politik do të ishte një vlerë e shtuar në këtë drejtim. Ndonëse përmbajtja konkrete e dokumentit u la për t'u diskutuar e për t'u vendosur në një kohë të ardhme, paraprakisht, në parim, u ra dakord për fushën e veprimit të tij, për nevojën e përcaktimeve të qarta të koncepteve kryesore dhe për nevojën e përfshirjes në të, të pjesëve të veçanta ku të shpallehin parimet, objektivat dhe politikat konkrete në zbatim të tyre. Ideja e krijimit të një mekanizmi monitorues të jashtëm, që kërkonte nga shtetet raportime të rregullta për zbatimin e dokumentit të ri, të cilat do të shqyrtoheshin, për komente dhe rekomandime, nga një komitet ekspertësh të Këshillit të Europës, nuk gjeti mbështetje të gjerë. Për disa, ky mekanizëm do të sillte përfitime të mëdha, ndërsa disa të tjerë mendonin se ai do të diktonte detyrime të panevojshme për shtetet. Po kështu, për disa, ky dokument duhet të kishte karakter detyrues, ndërsa për të tjerë jo.

15. Në takimin e tij plenar, më 10 mars të vitit 2008, Komiteti Drejtues i Këshillit të Europës për Arsimin, si organizmi që porositi studimin, duke patur parasysh të gjitha komentet e organizmave të tjerë, e mirëpriti atë dhe vendosi "të vazhdojë debati për dokumentin kuadrin politik, duke përgatitur edhe një draft që përmbante si variantin detyrues, ashtu edhe atë jo detyrues, duke mbajtur parasysh edhe punën që Grupi Këshillimor Ad hoc për Edukimin për Qytetari Demokratike dhe për të Drejtat e Njeriut po kryente për dokumentin që do të përmbante çështjet themelore për politikbërësit". Komiteti Drejtues i Këshillit të Europës për Arsimin caktoi në këtë grup disa nga anëtarët e tij me përvojë në çështjet e arsimit dhe të rinisë. Komiteti kërkoi që të dyja variantet të dorëzoheshin në kohën e duhur për t'u shqyrtuar në takimin e tij në mars të vitit 2009.

16. Grupi i hartimit u mblodh tri herë, në qershor, shtator dhe nëntor të vitit 2009. Në takimin e parë, grupi shkëmbeu ide për aspektin ligjor, formën e

përgjithshme dhe përmbajtjen e të dy drafteve dhe vendosi t'u kërkojë autorëve një studim paraprak për të përgatitur draftin e parë të të dy teksteve. Në takimin e dytë, ai shqyrtoi dhe bëri komente të shumta për të dy draftet. Këto komente u mbajtën parasysht në përgatitjen e drafteve të reja, të cilat u paraqitën në takimin e tretë. Në këtë takim u bënë kompromiset e duhura për të gjitha çështjet e debatuar dhe tekstet në fjalë u përmirësuan më tej. Disa çështje u lanë për t'u shqyrtuar dhe për t'u vendosur nga Byroja e Komitetit Drejtues të Këshillit të Europës për Arsimin në takimin e dhjetorit. Byroja aprovoi draftin përfundimtar për seancën plenare të Komitetit.

17. Të dy draftet iu paraqitën anëtarëve të Komitetit Drejtues të Këshillit të Europës për Arsimin, në seancën plenare në mars të vitit 2009. Në thelb, draftet ishin pothuajse të njëjtë përsa e përket nevojave dhe qëllimeve që duhet të përmbushnin. Ndryshimet ndërmjet tyre kishin të bënin me formën dhe pasojat ligjore; njëri si një konventë detyruese e shkruar me gjuhën e detyrimeve dhe tjetri si një kartë jodetyruese. Ndryshimi i vetëm thelbësor ndërmjet tyre, në përmbajtje, ishte në çështjen e monitorimit: varianti *konventë* parashikonte një mekanizëm që kërkon nga shtetet raportimin dhe mbikëqyrjen e jashtme (ndonëse të lehtë), ndërsa varianti *kartë* mbështetej në vlerësimin e brendshëm nga vetë shtetet.

18. Në debatin që vijoi, përfaqësuesit e shteteve që morën fjalën në seancë pranuan nevojën e miratimit të një dokumenti të ri, ndërsa shumica e anëtarëve parapëlqyen formën jodetyruese të këtij dokumenti, pra kartën. Për këtë arsye, komiteti, në mars të vitit 2009, mori vendimin e protokolluar si më poshtë:

Komiteti:

- i kënaqur nga rezultatet e kënaqshme të punës së grupeve për përgatitjen e dokumentit kuadër politik;
- shqyrtoi dy propozimet e paraqitura nga grupi dhe shprehu parapëlqimin e tij për një Kartë të EQD/EDNJ;
- theksoi dobinë e një karte të tillë për sigurimin e politikave të qëndrueshme për zhvillimin e EQD/EDNJ dhe të praktikave që lidhen me to në shtetet anëtare;
- përvijoi rrugën për finalizimin e saj përpara seancës plenare të Komitetit Drejtues të Këshillit të Europës për Arsimin në vitin 2010..."

19. Hapi i parë në këtë drejtim ishte ftesa që të gjithë delegatët të duhet dorëzonin brenda një afati të caktuar propozime për shtesa të mundshme të tekstit ekzistues. Këto propozime do të shqyrtoheshin nga një grup i vogël i përbërë nga kryetarë dhe ish-kryetarë të Komitetit Drejtues të Këshillit të Europës për Arsimin, të ndihmuar edhe nga autorët e studimit dhe të hapur ndaj pjesëmarrjes së delegacioneve që ofruan propozime dhe shprehën dëshirën të

merrnin pjesë në procesin e hartimit të drafteve paraprahe. Grupi u mbledh në qershor të vitit 2009 dhe, pasi shqyrtoi të gjitha shtesat e propozuara, mori vendimet përkatëse për pranimin apo refuzimin e secilës prej tyre. Në disa raste, grupi bëri ndryshime në tekstin ekzistues mbi bazën e rekomandimeve e, në pak raste, bëri edhe formulime të reja thelbësore, që kishin si pikënisje bazë vetë shtesën e propozuar.

20. Byroja e Komitetit Drejtues të Këshillit të Europës për Arsimin u mbledh në datat 9 dhe 10 shtator 2009 dhe shqyrtoi tekstin e ndryshuar në takimin e qershorit në dritën e këshillës së dhënë nga Departamenti i Këshillimit Ligjor të Këshillit të Europës në datën 4 shtator 2009. Sipas kësaj këshille, për të qenë në përputhje me praktikën e Këshillit të Europës, Karta duhet të miratohej në kuadrin e një rekomandimi të Komitetit të Ministrave. Byroja dorëzoi të dy draftet e rishikuara dhe këshillën ligjore për një takim të jashtëzakonshëm të Komitetit Drejtues i Këshillit të Europës për Arsimin, të mbajtur në 10-11 dhjetor 2009. Ajo i kushtoi vëmendje edhe draftit të parë të këtij memorandumi dhe e dorëzoi atë për takimin plenar. Anëtarët e Komitetit Drejtues i Këshillit të Europës për Arsimin u ftuan të jepnin komentet për këtë tekst dhe të propozonin shtesa ose ndryshime për secilin prej teksteve.

21. Në takimin e tij të dhjetorit, Komiteti Drejtues i Këshillit të Europës për Arsimin shqyrtoi shtesat e propozuara për tekstin e kartës. Ai miratoi rishikimin e saj në përputhje me këshillën ligjore, në bazë të së cilës Karta u bë shtesë e një Rekomandimi të Komitetit të Ministrave dhe parathënia e saj u bë hyrja e rekomandimit. Rekomandimet jodetyruese vulosin edhe natyrën jodetyruese të vetë Kartës. Po kështu, në takim u ra dakord edhe për disa shtesa të tjera. Komiteti diskutoi shtesat e propozuara për memorandumin shpjegues dhe kërkoi përgatitjen e një drafti të ri.

22. Në takimet e tij të 24 dhe 26 shkurt të vitit 2010, Komiteti mori në shqyrtim versionin e fundit të draftit të rekomandimeve të Komitetit të Ministrave drejtuar shteteve anëtare për Kartën Europiane për edukimin për qytetari demokratike dhe për të drejtat e njeriut dhe memorandumin e saj shpjegues. Ai vendosi të miratojë draftin e rekomandimeve dhe t'ia dërgojë atë Komitetit të Ministrave për miratim. Komiteti shqyrtoi memorandumin shpjegues të draftit të rekomandimeve dhe e dërgoi për informacion pranë Komitetit të Ministrave.

## **II. Komente për rekomandimet dhe kartën**

*Rekomandimi: hyrja dhe paragrafët zyrtarë*

23. Rekomandimi fillon me paragrafë hyrës dhe thekson në paragrafin 1<sup>2</sup>, pushtetin në të cilin është miratuar karta, i përdorur edhe më parë në raste të miratimit të kartave, veçanërisht në fushën e sportit. Për rrjedhojë, siç ndodh rëndom, pjesa tjetër e parathënies ka të bëjë me arsyet që i çuan shtetet anëtare në miratimin e kartës dhe ia bën të qartë lexuesit fillesën dhe synimet e saj. Forma dhe një numër paragrafesh që fillojnë me folje të tilla, si "duke kujtuar", duke pasur parasysh" etj., gjenden edhe në një numër dokumentesh që kanë statusin e një traktati, por nuk janë tregues i një statusi të tillë. Një formë e tillë përdoret zakonisht në rekomandimet e Komitetit të Ministrave, të cilat gjithmonë, janë jodetyruese.

24. Paragraf-t 2 dhe 3 të hyrjes kujtojnë misionin kryesor të Këshillit të Europës për të nxitur e zhvilluar të drejtat e njeriut, demokracinë dhe shtetin e së drejtës dhe bindjen se arsimi mund të luajë një rol qëndror në përmbushjen e këtij misioni. Kjo përbën themelin e të gjithë projektit të EQD/EDNJ që nga viti 1997 dhe vetë karta është shprehje e angazhimit të shteteve anëtare ndaj këtij projekti dhe ndaj standardeve që ata i vendosin për t'i përmbushur.

25. Paragrafët 4 dhe 5 të hyrjes hedhin një vështrim në fillesat ligjore të së drejtës për arsimim, si në Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut dhe në instrumentet e Kombeve të Bashkuara, të cilët kërkojnë, për shembull, që arsimi "të fuqizojë respektin për të drejtat e njeriut dhe liritë themelore" dhe "të aftësojë çdo individ të marrë pjesë efektivisht në një shoqëri të lirë" (Pakti ndërkombëtar për të drejtat ekonomike, shoqërore dhe kulturore, 1996, Neni 13/1), ashtu dhe në Deklaratën e Vienës të vitit 1993, e cila vë theksin në rëndësinë e integritit të çëshjes së të drejtave të njeriut në programet arsimore dhe kërkon prej shteteve ta realizojnë atë.

26. Paragrafët 7 dhe 8 të hyrjes citojnë deklaratat kryesore politike të ministrave dhe rekomandimet e organizmave të Këshillit të Europës, të cilët përbëjnë hapa të rëndësishëm në rrugën e miratimit të Kartës. Pararendësi më i rëndësishëm i Kartës është Rekomandimi (2002) 12 i Komitetit të Ministrave për Edukimin për Qytetari Demokratike, të cilit i kemi referuar më sipër e që ngrihet mbi themele dhe synime të ngjashme.

27. Paragrafi 11 i hyrjes vendos Kartën në një kontekst global, duke shprehur dëshirën që kjo do të ndihmojë në arritjen e synimeve të Programit Botëror për të Drejtat e Njeriut, të cilat janë shumë të ngjashme, meqë Këshilli i Europës është partner rajonal i Kombeve të Bashkuara për programin në Europë.

---

<sup>2</sup> Paragrafët e parathënies nuk kanë numra në tekst, por renditen në memorandumun shpjegues për të lehtësuar referencat (1 për paragrafin e pare, 2 për të dytin e kështu me radhë).



28. Paragrafi 12 i hyrjes i referohet Vitit European të Qytetarisë përmes Arsimit 2005, një ngjarje e shënuar në projektin EQD/EDNJ dhe hedh dritë mbi një ndër synimet themelore të Kartës, që është të shndërrojë praktikën e mira të politikave arsimore të zbatuara në shtetet anëtare të evidentuara gjatë vitit, në praktika model dhe t'i bëjë ato të njohura në të gjithë Europën.

29. Paragrafi 13 i hyrjes pranon një tipar të arsimit, i cili përshkruhet në mënyrë të veçantë në paragrafin 4 dhe përshkon të gjithë kartën. Kjo është çështja e ndryshimeve që ekzistojnë ndërmjet shteteve anëtare, ndryshime që gjithmonë duhet të respektohen. Këto ndryshime mund të jenë të karakterit kushtetues ose mund të lidhen me mënyrën se si organizohet arsimi. Për këtë arsye, të gjitha politikën dhe praktikën e shpallura në kartë duhet të zbatohen nga të gjitha shtetet anëtare, por gjithmonë në përputhje me veçoritë e sistemeve të tyre kushtetuese dhe strukturore.

30. Paragrafi 14 i hyrjes pranon rolin qendror që luajnë organizatat joqeveritare dhe ato rinore që veprojnë në fushën e arsimit. Në fakt, arsimi joformal gjithnjë e më shumë po realizohet nga organizatat të tilla. Në këtë mënyrë ato po luajnë një rol të madh edhe në arsimin formal dhe, për këtë arsye, po mështeten edhe nga shtetet. Në këtë paragraf, si dhe në paragrafin 10, pranohet vlera e kontributit të tyre dhe nevoja që ato kanë për mbështetje.

31. Paragrafët që vijojnë hyrjen janë paragrafët zyrtarë të rekomandimit. Ata janë operative dhe për këtë arsye janë shkruar në mënyrë dëftore. Komiteti rekomandon se qeveritë e shteteve anëtare të zbatojnë masa që bazohen në shtojcat e Kartës dhe të sigurojnë që ato të përhapen gjerësisht në autoritetet përgjegjëse për arsimin dhe rininë. Së fundi, Sekretari i Përgjithshëm udhëzohet t'ua bëjë të njohura rekomandimet Shteteve Anëtare të Konventës Kulturore Europiane, të cilët nuk janë, në të njëjtën kohë, anëtarë të Këshillit të Europës dhe organizatave ndërkombëtare. Kjo dukuri pasqyron karakterin ndërkombëtar të lëvizjes për edukimin për qytetari demokratike dhe për të drejtat e njeriut, si dhe dëshirën që Karta e re të shtrijë ndikimin e saj brenda dhe përtej kufijve të Europës.

## **Karta**

### Titulli

32. Termi "kartë" përdoret në praktikën ndërkombëtare, si për instrumentet detyruese, shembulli më i shquar i të cilit është Karta e Kombeve të Bashkuara, ashtu edhe për ato jodetyruese, siç është Karta e Bashkimit

European e të Drejtave dhe Detyrimeve Themelore (e miratuar në vitin 2000: në kuadrin e Traktatit të Lisbonës 2005, pjesa më e madhe e shteteve të Bashkimit Europian (BE) pranuan që kjo kartë të shndërrohet në dokument detyrues për ta, ndërsa për disa shtete të tjerë mbetet një dokument jodetyrues). Termi kartë përdoret me kuptim të dyfishtë edhe në praktikën e Këshillit të Europës: Karta Sociale Europiane (1961, e rishikuar në vitin 1996) është detyruese, ndërsa Karta Europiane për Pjesëmarrjen e të Rinjve në jetën vendore dhe rajonale (2003) nuk ka karakter detyrues. Titulli dhe forma e kartës u zgjodhën për të treguar dëshirën për një dokument me më shumë peshë se ato të mëparshmit, të miratuar nga Këshilli i Europës në këtë fushë. Meqë qëllimi i shteteve anëtarë, ishte që Karta e Këshillit të Europës për Edukimin për Qytetari Demokratike dhe për të Drejtat e Njeriut të ishte një dokument jodetyrues nga pikëpamja e së drejtës publike ndërkombëtare, që në fillim, u arrit marrëveshja që të shtohet nëntitulli "Kartë pa statusin e Konventës". Megjithatë, më parë ishte vendosur që Karta do të miratohej në kuadrin e një rekomandimi dhe, për këtë arsye, nuk do të ishte e nevojshme të shtohet nëntitulli i mësipërm, meqë rekomandimet dhe gjithçka që varet prej tyre nuk kanë karakter detyrues. Për këtë arsye, u pranua që titulli të shoqërohej me fjalët "e miratuar në kuadrin e Rekomandimit CM/Rec (2010) 7 të Komitetit të Ministrave". Edhe nëse karta, që ndodh shpesh, do të botohet pa tekstin që e lidh me rekomandimin, vetëm këto fjalë do ta qartësoni statusin e saj jodetyrues.

## *Pjesa I. Deklarata të përgjithshme*

### 1. Fusha e veprimit

33. Kjo pjesë ka të bëjë me fushën e veprimit të Kartës. Një ndër mangësitë që është vënë re në instrumentet e mëparshme, ishte fakti që shumë prej tyre e trajtonin edukimin për qytetarinë demokratike dhe edukimin për të drejtat e njeriut të shkëputur nga njëri-tjetri. Vendimi për t'i trajtuar ato së bashku ishte një zgjedhje e vetëdijshme dhe e mençur. Trajtimi tërësor e përfshirës i tyre në kartë ishte një vlerë e shtuar për të. Një ndër çështjet që lindi në këtë kontekst, është ajo që ka të bëjë me mënyrën si do të trajtohen disa prej çështjeve, njëherazi të dallueshme dhe në lidhje me njëra-tjetrën. Katër prej këtyre çështjeve janë përmendur në tekst. "Edukimi ndërkulturor" synon të mbrojë demokracinë dhe të zhvillojë të drejtat e njeriut përmes zhvillimit të njohurive, aftësive dhe qëndrimeve të nevojshme për mirëkuptim dhe respekt të ndërsjellë në një shoqëri shumëkulturëshe. "Arsimi i barabartë" dhe "Edukimi për paqe" nuk kanë nevojë për shpjegim. Sipas një raporti të Drejtorit të Përgjithshëm të UNESCO në gusht të viti 2005, "Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm" është pjesë e përgatitjes për qytetari të përgjegjshme, të përkushtuar ndaj idealeve të

një bote të qëndrueshme, të drejtë, të barabartë dhe në paqe, në të cilën individët duhet të kujdesen për mjedisin dhe të japin ndihmesën e tyre në ruajtjen e barazisë së kushteve ndërmjet brezave". Synimi i Dekadës së Kombeve të Bashkuara për Arsimin për Zhvillim të Qëndrueshëm (2005-2015) është të nxisë një arsim të tillë dhe bërjen e tij pjesë të kurrikulës dhe të programeve të arsimit formal, joformal dhe informal. Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm është i ngjashëm me EQD/EDNJ, por rrënjët e tij janë në lëvizjen mjedisore në kuadrin e Kombeve të Bashkuara dhe i tillë është edhe fokusi i tij kryesor. Në mënyrë të ngjashme, të gjitha çështjet e përmendura më sipër kanë nga një dimension specifik, që mbulohet, në shkallë të madhe nga koncepti i EQD/EDNJ, por prirja e tyre është të përqendrohen në një fushë të veçantë. Për këtë arsye, u pranua që Karta nuk duhet të merret me çështje të tilla ( që lidhen me të), në mënyrë specifike, por t'i trajtojë ato vetëm në rastet kur priten ose ndërveprojnë me EQD/EDNJ.

## 2. Përkufizime

34. Me gjithë punën e madhe të bërë në fazën e parë të projektit për përkufizimet, konceptet etj., përsëri, në dokumentet kuadër ekzistues politikë mungonin përcaktime të qarta të termave të tillë kyç, si: "edukimi për qytetari demokratike" dhe "edukimi për të drejtat e njeriut". Përkufizimet ekzistuese, në thelb, ishin deklarata të gjata të atyre që termi përfshinte, pra nuk ishin përkufizime të vërteta, por përshkrime. Në diskutimet e bëra për draftin e një dokumenti të ri, u shpreh pa mëdyshje nevoja për të pasur përcaktime konçize e të qarta të termave kyç, të kuptueshme nga të gjithë politikbërësit ose të tjerët që kërkojnë të kuptojnë dhe të zbatojnë dokumentin e ri.

35. Dy përkufizimet kyç, në nënparagrafët *a* dhe *b*, morën parasysh përkufizimet ekzistuese: në rastin e edukimit për qytetari demokratike, u mor parasysh përkufizimi i përdorur për vitin e qytetarisë; në rastin e edukimit për të drejtat e njeriut, u mor parasysh përkufizimi i përdorur nga zyra e Komisionerit të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut. Pas rishikimesh të vazhdueshme, "ato u përpunuan derisa, në një aspekt, bashkohen në fjalët "fuqizimi i individit" e, më tej, dallojnë në varësi të fokusit të tyre të veçantë; aftësia për të jetuar në një shoqëri demokratike, nga njëra anë, dhe nxitja e mbrojtja e të drejtave të njeriut, nga ana tjetër. Në të dyja përkufizimet vihet theksi në rezultatet e një arsimit, që synon jo vetëm njohuritë, por aftësimin dhe fuqizimin e individit për të ndërmarrë veprimet e duhura në jetë.

36. Përkufizimet në nënparagrafët *c*, *d* dhe *e* bazohen në ato që përdoren në Kompas, manuali i edukimit me të drejtat e njeriut për të rinjtë, i botuar nga Këshilli i Europës në vitin 2002. Por, përmbajtja e tyre u zgjerua dhe u përpunua më tej gjatë punës për to. Për shembull, u pranua që një tipar dallues i

arsimit formal është fakti që ai shoqërohet me diplomë. Arsimi joformal shoqërohet me certifikatë, në më shumë raste se arsimit informal, por, gjatë hartimit, u pranua që këto çështje të mos trajtohen me hollësi në tekst.

### 3. Marrëdhëniet ndërmjet EQD dhe EDNJ

37. Marrëdhëniet e rëndësishme ndërmjet EQD dhe EDNJ, me sa janë në dijeni autorët e këtij teksti, më parë nuk ka qenë objekt i ndonjë përkufizimi. Në pjesën më të madhe të dokumenteve të Këshillit të Europës që lidhen me këtë program të nisur në vitin 1997, ku janë përdorur të dy termit, këta thjesht vendosen pranë njëri-tjetrit (EQD/EDNJ), gjë që nuk ndihmon të sqarohet marrëdhëniet ndërmjet tyre. Kjo është e vërtetë edhe për termit e referencës të përdorura për studimin, çka çoi në komentit e shprehur në të që kjo çështje nuk mund të shmangej më, por duhej të trajtohej në ndonjë prej dokumenteve të reja në këtë fushë. Të dy termit mbivendosen, sepse të drejtat që janë të rëndësishme për qytetarinë, për shembull, e drejta për të votuar, e drejta për lirinë e fjalës dhe për lirinë e organizimit, janë të drejta klasike të të drejtave të njeriut, të cilat i përkasin si fushës së EDNJ, ashtu edhe EQD. Megjithatë, ndërmjet tyre ekzistojnë dallime të cilat bëhen të qarta në paragrafin 3 dhe kanë të bëjnë më shumë me fokusin dhe fushën e zbatimit se sa me qëllimet dhe praktikatat.

### 4. Strukturat kushtetuese dhe përparësitë e shteteve anëtare

38. Ky paragraf bazë merr parasysh çështjet e diskutuara më sipër lidhur me paragrafin e hyrjes 13. Gjatë punës për hartimin e draftit dhe debateve lidhur me të, u pranua që shtetet anëtare kanë nevojë të gëzojnë të drejtën të vendosin për mjetet që duhet të përdorin për të zbatuar nenet e Kartës, për shkak të ndryshimeve që ekzistojnë në sistemet e tyre kushtetuese dhe arsimore, madje më shumë në arsim se në fushat e tjera të bashkëpunimit Europian. Për shembull, disa sisteme arsimore janë shumë të centralizuara, me kurrikul dhe metoda të përcaktuara në nivel qendror; të tjerë janë shumë të decentralizuara, me pushtete vendore dhe shkolla individuale që kanë autonomi të madhe në kuadrin e një kornize të caktuar objektivash; në shtetet federale përgjegjësia për çështjet arsimore i takon qeverive të shteteve të veçanta që formojnë federatën. Që këtej, buron nevoja për nënparagrafin *a*. Nënparagrafi *b* pranon, siç bëhet e qartë gjatë gjithë programit dhe veçanërisht gjatë vitit të qytetarisë, se shtete anëtare të ndryshme janë edhe në faza të ndryshme në fushën e legjislacionit dhe të praktikës së EQD dhe EDNJ. Në disa shtete, lëndët që trajtojnë qytetarinë demokratike dhe të drejtat e njeriut janë pjesë e kurrikulës dhe e praktikës shkollore prej shumë vitesh, ndërkohë që, në të tjerë, procesi ndodhet në hapat e para. Kështu, përparësitë dhe nevojat e shteteve do të ndryshojnë, e për këtë arsye ata do të përqendrohen në pjesë të ndryshme të Kartës dhe me përparësi të

ndryshme trajtimi.

## *Pjesa II – Objektivat dhe parimet*

### 5. Objektivat dhe parimet

39. Struktura në vazhdim e Kartës përbëhet nga një radhë objektivash e parimesh të shpalluara në mënyrë të përgjithshme në paragrafin 5, një pjesë e të cilave rimerren e trajtohen më hollësisht në paragrafët 6-16. Gjerësia dhe karakteri i përgjithshëm i pikave të paragrafit 5 e ruajnë rëndësinë e tyre, pasi ato përshkruajnë thelbin e veprimtarisë së shteteve anëtare në fushën e EQD/EDNJ.

40. Fjala "udhëzues" që ndodhet në hyrje nuk është e parëndësishme: objektivat dhe parimet ofrojnë udhëzime, të cilat nuk janë as një dokument i shkruar për politikën, legjislacionin ose praktikën, por as një sfond i thjeshtë informativ. Hartuesit e draftit shqyrtuan variante të tjera, atë më detyrues ("duhet të bazojë legjislacionin etc... në objektivat dhe parimet e mëposhtme") dhe atë më pak detyrues (duhet të marrin parasysh objektivat dhe parimet e mëposhtme në ...), por ata zgjodhën variantin ekzistues.

a. Ky objektivi sjell në vëmendje Deklaratën e Vienës të Kombeve të Bashkuara të vitit 1993, lidhur me garantimin e shanseve për EQD dhe EDNJ për të gjithë dhe Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut (neni 1), që e shtrin këtë të drejtë në të gjithë territorin e shtetit dhe jo thjesht te qytetarët.

b. Arsimi, veçanërisht në fushën e qytetarisë dhe të të drejtave të njeriut, është një proces që zgjat gjatë gjithë jetës. Ky fakt është një temë e përhershme në programet e Këshillit të Europës. Lista e pjesëmarrësve (të interesuarve) në proces, jo pa qëllim, është e gjatë dhe e hapur ("përfshirëse") dhe mbulon të gjitha llojet e institucioneve qeveritare dhe joqeveritare.

c. Ky parim na kujton se të gjitha format e të nxënimit kanë vlerën e tyre në këtë proces, megjithëse shtetet, në mënyrë të pritshme prej tyre, mbështetin më shumë formën e arsimit, të cilin financojnë dhe ku ata kanë ndikimin më të madh, që është arsimi formal.

d. Kontributi i domosdoshëm i OJQ dhe i organizatave rinore theksohet në paragrafin 14 të hyrjes. Referenca "të mbështesë" është e përgjithshme: nuk ka detyrim për të mbështetur, për të financuar etj., por parimi pranon se OJQ dhe organizatat rinore kanë nevojë për mbështetje, qoftë kjo nga shteti ose

nga burime të tjera. Referenca e veçantë për organizatat rinore përfshin edhe organizatat e nxënësve, si partnerë të rëndësishëm në edukimin e të drejtave të njeriut.

e. Do të ishte e pakuptimtë që institucionet arsimore, nga njëra anë, të mësonin respektin për parimet demokratike dhe të drejtat e njeriut dhe, nga ana tjetër, të drejtoheshin vetë në mënyrë krejtësisht jo demokratike. Nevoja për qeverisje demokratike në shkollë dhe në institucionet e tjera arsimore është theksuar vazhdimisht në programet e Këshillit të Europës. Ky parim përmban thelbin e paragrafit 8, në pjesën e tretë – Politikat.

f. Respekti për diversitetin është një tjetër parim thelbësor i Këshillit të Europës (shih, për shembull, fushatën rinore "Të gjithë të ndryshëm, të gjithë të njëjtë") dhe një ndër synimet dhe përfitimet e EQD/EDNJ është rritja e mirëkuptimit dhe shmangja e konfliktit. Shembujt e besimeve të ndryshme dhe të grupeve etnike janë dhënë në kontekstin e ndërtimit të mirëkuptimit dhe të respektit, por i njëjti parim zbatohet edhe në grupet ndërmjet të cilëve mund të lindin lehtë keqkuptime dhe konflikte.

g. Theksi në këtë parim, si dhe në përkuzimet e EQD dhe EDNJ, nuk vihet thjesht në njohuritë dhe aftësitë, por në veprimin qytetar.

h. Ky parim zbatohet në të gjitha fazat e trajnimit, në atë fillestar dhe në punë, gjë që bëhet e qartë në paragrafin 9, në të njëjtën pjesë. Ky parim është veçanërisht i rëndësishëm për sektorët joqeveritarë dhe rinorë, mundësitë e të cilëve për të trajnuar vullnetarë dhe lehtësues të procesit të të nxënimit janë të kufizuara, të përkohëshme dhe mbështeten te donatorët.

i. Synimi i partneritetit dhe i bashkëpunimit ndërmjet vendimmarrësve dhe të interesuarve të shumtë nuk është i lehtë për t'u përmbushur, veçanërisht për faktin se interesat e tyre mund të jenë jo vetëm të ndryshme, por edhe kundërshtuese dhe, për këtë arsye, shoqërohen edhe me konkurrencë për të përfituar nga burimet e kufizuara. Megjithatë, bashkëpunimi ndërmjet tyre mund të sjellë përfitime, për të cilat shtetet ja vlejné të përpiqen e të përkushtohen.

j. Karta në vetvete është rezultat i bashkëveprimit ndërkombëtar ndërmjet 47 shteteve anëtare të Këshillit të Europës, dhe në fushën e arsimit, ndërmjet të gjitha shteteve anëtare të Konventës Kulturore Europiane. Baza e saj ligjore dhe politike qëndron te bashkëpunimi, për këtë arsye pritet që, edhe në të ardhmen, theksi të vihet në qëllimet dhe në parimet e vazhdimit të këtij bashkëpunimi. Përveç vlerës së madhe që ka në vetvete, bashkëpunimi dhe

shkëmbimi i praktikave të mira mund të sjellë përfitime praktike të ndjeshme, për shembull, duke pakësuar përsëritjet e panevojshme, kostot dhe duke nxitur përpjekjet e përbashkëta.

### *Pjesa III – Politikat*

41. Paragrafët 6 deri 16 të Kartës përmbajnë pikat kryesore udhëzuese. Ato shpallin politikat në fusha të veçanta të cilat synojnë t'u japin zë praktik objektivave dhe parimeve të renditura në paragrafin 5. Politikat shpallen në terma të përgjithshëm, duke u dhënë shteteve anëtare fleksibilitet në zbatimin e tyre.

#### 6. Arsimi formal, i përgjithshëm dhe profesional

42. Siç pohohet më sipër, kjo çështje përbën thelbin e përpjekjeve të Këshillit të Europës në këtë fushë, jo për të përjashtuar format e tjera të arsimit, por sepse ai priret të prodhojë përfitime të rëndësishme, si një fushë ku shtetet janë në gjendje të bëjnë ndryshime dhe të arrijnë rezultate. Kjo pikë është një shembull i mirë i zbatimit të pikave të paragrafit 4, sepse në disa shtete, kushtetutat dhe strukturat e tyre do t'u lejojnë qeverive qendrore të paraqesin ndryshime të drejtpërdrejta në kurrikul, kurse qeveri të tjera qendrore vetëm mund të kërkojnë dhe të nxisin autoritete të tjera që kanë pushtetin ta bëjnë një gjë që të tillë. Në shtetet federale, qeveria federale, vështirë të ketë ndonjë përgjegjësi të paraqesë ose të kërkojë ndonjë gjë për arsimin. Disa shtete e kanë bërë këtë shumë kohë më parë, ato i kanë vënë vetes të tjera përparësi, ndërkohë që, për të tjerë shtete, çështjet e arsimit janë parësore. Karta lejon liri për përdorimin e metodave të ndryshme dhe për zgjedhje të ndryshme. Një tjetër fushë, ku janë të pranishme ndryshimet, është ajo e raportit ndërmjet drejtimit të përgjithshëm dhe atij profesional në organizimin e arsimit formal. Teksti kërkon përdorimin e një gjuhe të përshtatshme për çdo sistem.

43. Hartuesit e draftit morën parasysh një sugjerim të bërë nga Organizatat Joqeveritare Ndërkombëtare Arsimore për të përfshirë termin "kompetencë" në EQD dhe EDNJ në nivele të ndryshme të arsimit, në vend të përfshirjes së këtyre lëndëve në kurrikul. Termi "kompetencë" po përdoret gjithnjë e më shumë në literaturën akademike dhe në praktikë për të përshkruar një grup aftësish, njohurish dhe qëndrimesh. Ajo fokusohet në rezultatet arsimore më shumë se në objektivat e nxënësit dhe pranon se këto rezultate mund të jenë komplekse. Grupi i punës vuri në dukje natyrën tërheqëse të terminologjisë bashkëkohore, por arriti në përfundimin se termi kompetencë, ndryshe nga

termi kurrikul, ende nuk kuptohej e nuk kishte zënë vend mjaftueshëm në fjalorin e përditshëm. Megjithatë, qëllimi i këtij paragrafi është të theksojë idenë se arsimit nuk duhet të jetë thjesht çështje e transmetimit të njohurive, por edhe e zhvillimit të aftësive dhe e ndikimit të qëndrimeve për të nxitur pjesëmarrjen aktive në shoqëri dhe për të mbrojtur të drejtat e njeriut.

44. Fjalja e dytë nënvizon idenë se të bësh EQD dhe EDNJ pjesë të kurrikulës nuk është çështje e një akti të vetëm. Gjithmonë do të ekzistojë nevoja e vazhdueshme për të rishikuar kurrikulën, që ajo t'i shërbejë qëllimit të hartimit të saj dhe metodat e mësimdhënies të jenë efektive. Kjo është e vërtetë për të gjitha shtetet, pavarësisht nga koha e përfshirjes së lëndëve të tilla në kurrikul.

## 7. Arsimit i lartë

45. Ndryshimet që ekzistojnë në institucionet e arsimit të lartë, të krahasuara me nivelet më të ulta të arsimit, pasqyrohen në fjalët hyrëse "duhet të nxisin përfshirjen" në vend të "duhet të përfshijnë". Kjo pasqyron faktin që, në pjesën më të madhe të shteteve, në mos në të gjitha, institucionet e arsimit të lartë, në përgjithësi, gëzojnë autonomi në hartimin e kurrikulës së tyre. Kjo shprehet edhe me termin e lirisë akademike, që ka qenë një ndër shqetësimet kryesore të Komitetit Drejtues për Arsimin e Lartë gjatë shqyrtimit të propozimit të vitit 2007, për një dokument kuadër politik të ri. "Institucionet e arsimit të lartë përshtatshme universitetet, por nuk kufizohen me to".

## 8. Qeverisja demokratike

46. Fjalja e parë e paragrafit thekson vlerën e dyfishtë të qeverisjes demokratike në institucionet arsimore: ajo ka vlerë si një metodë e efektshme e qeverisjes dhe, në mënyrë të veçantë, u ofron nxënësve shansin të zbatojnë në praktikë demokracinë dhe të drejtat e njeriut. Fjalja e dytë ka të bëjë me nxitjen e pjesëmarrjes aktive në një qeverisje të tillë "përmes mjeteve të përshtatshme". Ajo mund të përfshijë edhe struktura për pjesëmarrje të qëllimshme e të qëndrueshme të nxënësve në të gjitha nivelet e arsimit, gjë që pranohet gjerësisht si një ndër rrugët më të efektshme të ushtrimit të qytetarisë demokratike.

47. Koncepti "qeverisje" në anglisht (që është gjuha në të cilën është diskutuar karta) është mjaft kompleks, gjë që e bën të vështirë të përkthehet në gjuhë të tjera me një fjalë të vetme. Përmbajtja e këtij procesi shkon përtej kuptimit të tij si proces i thjeshtë manaxhimi dhe vendimmarrje në përputhje me vlerat dhe parapëlqimet e pranuar. Një ndër përcaktimet është ai që lidh konceptin e qeverisjes me "proceset dhe institucionet me anë të të cilave vlerat dhe



parapëlqimet kthehen në veprime kolektive që rritin sigurinë, mirëqenien dhe zhvillimin moral të një grupi dhe të individëve që bëjnë pjesë në të". Për shpjegime të mëtejshme, mund të konsultohet raporti i një konference të Këshillit të Europës për qeverisjen në arsimin e lartë, të mbajtur në vitin 2005, gjatë të cilës u zhvilluan diskutime të shumta lidhur me termin në fjalë, për kuptimin, përkthimin dhe zbatimin e tij praktik. Megjithëse konferenca u mor me arsimin e lartë dhe qeverisja e institucioneve të tjera është disi e ndryshme me të, shumë prej parimeve zbatohen kudo.

## 9. Trajnimi

48. EQD/EDNJ do të ishte jo i efektshëm, madje i pavlefshëm, pa trajnimin e mësuesve dhe të tjerëve të përfshirë në këtë edukim, si në sistemin arsimor dhe jashtë tij, për shembull, drejtuesit rinorë. Lënda ndryshon nga ato tradicionale. Ata që marrin përsipër të mësojnë të tjerët, në fillim duhet të mësojnë vetë. Metodrat më të mira të mësimdhënies janë edhe të ndryshme dhe, për këtë të arsye, duhet të përvetësohen. Ky paragraf thekson rëndësinë e trajnimit jo vetëm për mësuesit, por edhe për trajnerët.

## 10. Roli i organizatave qeveritare, i organizatave rinore dhe i të interesuarve të tjerë

48. Rëndësia e rolit të OJQ-ve dhe të organizatave rinore në EQD/EDNJ theksohet që në paragrafin 14 të hyrjes dhe në nënparagrafin *d* të paragrafit 5. Kjo nuk lidhet thjesht me faktin që ata janë pjesë e punës aktuale që zhvillohet në fushën e edukimit, por ata luajnë rol aktiv në punën kërkimore, në rritjen e vetëdijes së publikut dhe në përpjekjet e bëra për ta mbështetur këtë edukim në nivele të ndryshme të politikës e të qeverisjes. Shpeshherë, ata ofrojnë hapësirën e vetme ku nxënësit, fëmijët dhe të rinjtë mund të ushtrojnë dhe të praktikojnë të drejtat e njeriut dhe demokracinë. Puna e tyre dhe vlera e saj duhet të njihen dhe të pranohen dhe ky është synimi kryesor i këtij paragrafi. Fjalitë e fundit synon një publik më të gjerë; të ftojë në këtë proces aktorë të tjerë, veçanërisht median dhe publikun e gjerë, për të dhënë ndihmesën e tyre për nxitjen dhe bërjen më të njohur të EQD/EDNJ. Gjuha e përdorur ka karakter të përgjithshëm, për t'u lejuar shteteve ta zbatojnë atë në përshtatje me veçoritë e tyre. Këtu mund të përfshihen, për shembull, vendosja e shkrimeve në gazeta, reklama televizive, fushata, ëbsite, puna me shoqatat e prindërve dhe mësuesve, sindikatat, grupet e besimeve të ndryshme etj.

## 11. Kriteria për vlerësimin

50. Në EQD/EDNJ, si në çdo formë edukimi, duhet të ekzistojnë kritere për të vlerësuar efektshmërinë e tij. Përpjekje për të zhvilluar kritere të tilla, bashkë me treguesit përkatës, janë bërë edhe në nivel ndërkombëtar, ndonëse zhvillimi i tyre nuk është diçka e lehtë. Sigurisht, çdo shtet do të miratojë kriteret e tij të vlerësimit, por në këtë drejtim mund të ndihmohen nga shkëmbimi i përvojave, që vjen si rrjedhojë e bashkëpunimit ndërkombëtar, edhe për të zhvilluar kritere të përbashkëta, veçanërisht brenda Këshillit të Europës, grupimeve rajonale të shteteve Europiane ose përmes rrjetit të koordinatorëve (shih paragrafin 12, 14, 15 dhe 16 në vijim). Fjala e dytë vë theksin në rolin e rëndësishëm që ka informacioni që vjen nga nxënësit për zhvillimin e kritereve të vlerësimit.

## 12. Kërkimi shkencor

51. Kërkimi shkencor lidhet ngushtë me vlerësimin. Siç bëhet e qartë në fjalinë e parë, kërkimi nuk është domosdoshëm të kryhet nga qeveritë. Në të vërtetë, përvojat në fushën e arsimit, në një pjesë të madhe, janë krijuar nga OJQ, në nivel ndërkombëtar dhe shtetëror dhe nga agjenci të tjera, të pavarura nga qeveria, edhe në rastet kur gëzojnë mbështetjen e saj financiare për projekte të veçanta. Kërkimi kryhet për qëllime dhe përfitime të ndryshme. Qëllimi kryesor është të mundësojë vlerësimin e situatës aktuale dhe të sigurojë informacion krahasues për të ndihmuar ata që janë përfshirë në EQD/EDNJ të matin nivelin e arritjeve të tyre, të rritin efektivitetin dhe rendimentin e punës, gjë që do të ndikojë në pakësimin e përpjekjeve të pasuksesshme dhe në uljen e kostove. Fjala e dytë ofron një listë të gjatë, por jo shteruese, me shembuj të fushave të mundshme të kërkimit. Fjala e fundit, për ndarjen e kërkimit me shtete të tjera anëtare, lidhet me paragrafët 15 dhe 16, që flasin për bashkëpunimin.

## 13. Aftësi për nxitjen e kohezionit social, për vlerësimin e diversitetit dhe për manaxhimin e ndryshimeve dhe konflikteve

52. Ky paragraf thekson përsëri parimin e shprehur në paragrafin 5f dhe komentet në lidhje me të kanë vlerë edhe këtu. Ai del jashtë konceptit të ngushtë të mësimdhënies së EQD/EDNJ si lëndë dhe nxit zbatimin e parimeve të EQD/EDNJ në çdo fushë të edukimit. Thelbi qëndron në të nxënit për të jetuar së bashku në një shoqëri të larmishme, që respekton ndryshimet dhe zgjidh konfliktet pa dhunë. Siç bëhet e qartë në përkufizim, EQD/EDNJ nuk kanë të bëjnë vetëm ose edhe pjesërisht me njohuritë, por me përvetësimin e aftësive dhe ndryshimin e qëndrimeve. Referencë e veçantë ekziston edhe për luftën ndaj të gjitha formave të diskriminimit dhe dhunës, veçanërisht atyre që dëmtojnë shkollën, si keqtrajtimet dhe ngacmimet, qofshin këto fizike, psikologjike ose përmes internetit, gjë që sot po bëhet gjithnjë e më e

zakonshme.

#### *Pjesa IV – Vlerësimi dhe bashkëpunimi*

##### 14. Vlerësimi dhe rishikimi

53. Grupi i hartimit të draftit propozoi për një sistem vetëvlerësimi nga çdo shtet anëtar, duke u bazuar në faktin që pjesa më e madhe e shteteve anëtare nuk e mbështetën idenë e një sistemi të jashtëm monitorimi për arsye të ndryshme, duke përfshirë këtu edhe koston që kërkon një sistem i tillë. Ky vlerësim duhet të jetë i rregullt, tërësor dhe të shoqërohet nga hapa të tjerë vijues. Ky paragraf lidhet me paragrafin 11 për kriteret e vlerësimit, me paragrafin 13, në çështjen e kërimit dhe me paragrafin 15 për bashkëpunimin. Fjalja e dytë përmend veçanërisht mundësinë që shtetet kanë për të bashkëpunuar me njëri-tjetrin në procesin e vlerësimit dhe fjalja e tretë ka të bëjë me ndihmën që ata mund të kërkojnë nga Këshilli i Europës. Të dyja këto linja veprimi mund të jenë me shumë përfitime, por janë tërësisht vullnetare.

##### 15. Bashkëpunimi në të ardhmen

54. Ky paragraf kërkon mbështetje në shembujt e shkëlqyer të bashkëpunimit në këtë fushë ndërmjet shteteve anëtare të Këshillit të Europës, që nga viti 1997, dhe përqendrim në veprimtaritë që do të shoqërojnë Kartën. Tre prej nënparagrafëve *a*, *c* dhe *d* janë kryesisht për vetë qeveritë, ndërsa *b* dhe *e* kanë të bëjnë me mbështetjen që qeveritë ofrojnë ndaj bashkëpunimit të njerëzve dhe organizatave në territorin e tyre. Rrjetet e gjera në nivel Europian të koordinatorëve të EQD/EDNJ të shteteve anëtare dhe të OJQ e atyre rinore kanë arritur suksese në përpjekjet e tyre për të nxitur lidhje të tilla dhe bashkëveprimin që i shoqëron ato. Po kështu, duke vepruar së bashku, qeveritë mund të shmangin paralelizmat dhe mbivendosjet e kota dhe të përdorin burimet e kufizuara në mënyrë më të efektshme.

55. Termi "kodifikim" i përdorur në nënparagrafin *c* nënkupton kthimin e shembujve të praktikave të mira në një lloj norme që duhet të zbatohet më gjerësisht, e cila mund të ketë karakter rregullues, por të ndërtuar në formën e udhëzimeve ose të rekomandimeve. Nga natyra e vet, kodifikimi, kryesisht ka vlerë për shtetet individuale për të përshtatur zbatimin me veçoritë që ekzistojnë brenda juridiksionit të tyre, por është pranuar edhe mundësia e hartimit të udhëzimeve ose rregullave për t'u zbatuar nga disa shtete anëtare. Në fakt, vetë

Karta është një shembull i kodifikimit të praktikave të mira.

## 16. Bashkëpunimi ndërkombëtar

56. Ky paragraf zgjeron sferën e bashkëpunimit për të përfshirë të tjera organizata ndërkombëtare si partnerë të Këshillit të Europës në punën për EQD/EDNJ, kryesisht Kombet e Bashkuara, Bashkimin Europian dhe Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë. Të katër organizatat kanë lidhje të ngushta në nivel sekretariati dhe kanë organizuar takime të rëndësishme në këtë fushë, por ky paragraf ka qëllim të nxisë lidhje më të ngushta ndërmjet shteteve anëtare dhe brenda shteteve, meqë shpeshherë ndodh që shërbyesit civilë që punojnë për këtë çështje në një nga organizatat ndërkombëtare, nuk janë në dijeni të punës së bërë, për të njëjtën gjë, në organizatën tjetër. Qëllimi i paragrafit është të bëjë të ditura përfitimet nga Karta dhe nga politikat dhe praktikrat e zbatuara si rrjedhojë e saj në Europë e më tej. Ky paragraf nuk i pengon shtetet anëtare, që janë anëtare edhe të organizatave të tjera, të ndajnë përvojat dhe praktikrat e mira drejtpërdrejt me këto organizata.

# Agjentë të shitjeve të botimeve të Këshillit të Europës

## Agents de vente des publications du Conseil de l'Europe

### BELGIUM/BELGIQUE

La Librairie Européenne -  
The European Bookshop  
Rue de l'Orme, 1  
BE-1040 BRUXELLES  
Tel.: +32 (0)2 231 04 35  
Fax: +32 (0)2 735 08 60  
E-mail: [order@libeurop.be](mailto:order@libeurop.be)  
<http://www.libeurop.be>

Jean De Lannoy/DL Services  
Avenue du Roi 202 Koningslaan  
BE-1190 BRUXELLES  
Tel.: +32 (0)2 538 43 08  
Fax: +32 (0)2 538 08 41  
E-mail: [jean.de.lannoy@dl-servi.com](mailto:jean.de.lannoy@dl-servi.com)  
<http://www.jean-de-lannoy.be>

### BOSNIA AND HERZEGOVINA/ BOSNIE-HERZÉGOVINE

Robert's Plus d.o.o.  
Marka Marulića 2/V  
BA-71000, SARAJEVO  
Tel.: + 387 33 640 818  
Fax: + 387 33 640 818  
E-mail: [robertsplus@bih.net.ba](mailto:robertsplus@bih.net.ba)

### CANADA

Renouf Publishing Co. Ltd.  
1-5369 Canotek Road  
CA-OTTAWA, Ontario K1J 9J3  
Tel.: +1 613 745 2665  
Fax: +1 613 745 7660  
Toll-Free Tel.: (866) 767-6766  
E-mail: [order.dept@renoufbooks.com](mailto:order.dept@renoufbooks.com)  
<http://www.renoufbooks.com>

### CROATIA/CROATIE

Robert's Plus d.o.o.  
Marasovičeva 67  
HR-21000, SPLIT  
Tel.: + 385 21 315 800, 801, 802, 803  
Fax: + 385 21 315 804  
E-mail: [robertsplus@robertsplus.hr](mailto:robertsplus@robertsplus.hr)

### CZECH REPUBLIC/ RÉPUBLIQUE TCHÈQUE

Suweco CZ, s.r.o.  
Klecakova 347  
CZ-180 21 PRAHA 9  
Tel.: +420 2 424 59 204  
Fax: +420 2 848 21 646  
E-mail: [import@suweco.cz](mailto:import@suweco.cz)  
<http://www.suweco.cz>

### DENMARK/DANEMARK

GAD  
Vimmelskaftet 32  
DK-1161 KØBENHAVN K  
Tel.: +45 77 66 60 00  
Fax: +45 77 66 60 01  
E-mail: [gad@gad.dk](mailto:gad@gad.dk)  
<http://www.gad.dk>

### FINLAND/FINLANDE

Akateeminen Kirjakauppa  
PO Box 128  
Keskuskatu 1  
FI-00100 HELSINKI  
Tel.: +358 (0)9 121 4430  
Fax: +358 (0)9 121 4242  
E-mail: [akatilais@akateeminen.com](mailto:akatilais@akateeminen.com)  
<http://www.akateeminen.com>

### FRANCE

La Documentation française  
(diffusion/distribution France entière)  
124, rue Henri Barbusse  
FR-93308 AUBERVILLIERS CEDEX  
Tél.: +33 (0)1 40 15 70 00  
Fax: +33 (0)1 40 15 68 00  
E-mail: [commande@ladocumentationfrancaise.fr](mailto:commande@ladocumentationfrancaise.fr)  
<http://www.ladocumentationfrancaise.fr>

Librairie Kléber  
1 rue des Francs Bourgeois  
FR-67000 STRASBOURG  
Tel.: +33 (0)3 88 15 78 88  
Fax: +33 (0)3 88 15 78 80  
E-mail: [librairie-kleber@coe.int](mailto:librairie-kleber@coe.int)  
<http://www.librairie-kleber.com>

### GERMANY/ALLEMAGNE AUSTRIA/AUTRICHE

UNO Verlag GmbH  
August-Bebel-Allee 6  
DE-53175 BONN  
Tel.: +49 (0)228 94 90 20  
Fax: +49 (0)228 94 90 222  
E-mail: [bestellung@uno-verlag.de](mailto:bestellung@uno-verlag.de)  
<http://www.uno-verlag.de>

### GREECE/GRÈCE

Librairie Kauffmann s.a.  
Stadiou 28  
GR-105 64 ATHINA  
Tel.: +30 210 32 55 321  
Fax: +30 210 32 30 320  
E-mail: [ord@otenet.gr](mailto:ord@otenet.gr)  
<http://www.kauffmann.gr>

### HUNGARY/HONGRIE

Euro Info Service  
Pannónia u. 58.  
PF. 1039  
HU-1136 BUDAPEST  
Tel.: +36 1 329 2170  
Fax: +36 1 349 2053  
E-mail: [euroinfo@euroinfo.hu](mailto:euroinfo@euroinfo.hu)  
<http://www.euroinfo.hu>

### ITALY/ITALIE

Licosa SpA  
Via Duca di Calabria, 1/1  
IT-50125 FIRENZE  
Tel.: +39 0556 483215  
Fax: +39 0556 41257  
E-mail: [licosa@licosa.com](mailto:licosa@licosa.com)  
<http://www.licosa.com>

### MEXICO/MEXIQUE

Mundi-Prensa México, S.A. De C.V.  
Río Pánuco, 141 Delegación Cuauhtémoc  
MX-06500 MÉXICO, D.F.  
Tel.: +52 (01)55 55 33 56 58  
Fax: +52 (01)55 55 14 67 99  
E-mail: [mundiprensa@mundiprensa.com.mx](mailto:mundiprensa@mundiprensa.com.mx)  
<http://www.mundiprensa.com.mx>

### NETHERLANDS/PAYS-BAS

Roodveldt Import BV  
Nieuwe Hemweg 50  
NL-1013 CX AMSTERDAM  
Tel.: + 31 20 622 8035  
Fax: + 31 20 625 5493  
Website: [www.publidis.org](http://www.publidis.org)  
Email: [orders@publidis.org](mailto:orders@publidis.org)

### NORWAY/NORVÈGE

Akademika  
Postboks 84 Blindern  
NO-0314 OSLO  
Tel.: +47 2 218 8100  
Fax: +47 2 218 8103  
E-mail: [support@akademika.no](mailto:support@akademika.no)  
<http://www.akademika.no>

### POLAND/POLOGNE

Ars Polona JSC  
25 Obroncow Street  
PL-03-933 WARSZAWA  
Tel.: +48 (0)22 509 86 00  
Fax: +48 (0)22 509 86 10  
E-mail: [arspolona@arspolona.com.pl](mailto:arspolona@arspolona.com.pl)  
<http://www.arspolona.com.pl>

### PORTUGAL

Livraria Portugal  
(Dias & Andrade, Lda.)  
Rua do Carmo, 70  
PT-1200-094 LISBOA  
Tel.: +351 21 347 42 82 / 85  
Fax: +351 21 347 02 64  
E-mail: [info@livrariaportugal.pt](mailto:info@livrariaportugal.pt)  
<http://www.livrariaportugal.pt>

### RUSSIAN FEDERATION/ FÉDÉRATION DE RUSSIE

Ves Mir  
17b, Butlerova ul.  
RU-117342 MOSCOW  
Tel.: +7 495 739 0971  
Fax: +7 495 739 0971  
E-mail: [orders@vesmirbooks.ru](mailto:orders@vesmirbooks.ru)  
<http://www.vesmirbooks.ru>

### SPAIN/ESPAGNE

Mundi-Prensa Libros, s.a.  
Castelló, 37  
ES-28001 MADRID  
Tel.: +34 914 36 37 00  
Fax: +34 915 75 39 98  
E-mail: [libreria@mundiprensa.es](mailto:libreria@mundiprensa.es)  
<http://www.mundiprensa.com>

### SWITZERLAND/SUISSE

Planetis Sàrl  
16 chemin des Pins  
CH-1273 ARZIER  
Tel.: +41 22 366 51 77  
Fax: +41 22 366 51 78  
E-mail: [info@planetis.ch](mailto:info@planetis.ch)

### UNITED KINGDOM/ROYAUME-UNI

The Stationery Office Ltd  
PO Box 29  
GB-NORWICH NR3 1GN  
Tel.: +44 (0)870 600 5522  
Fax: +44 (0)870 600 5533  
E-mail: [book.enquiries@tso.co.uk](mailto:book.enquiries@tso.co.uk)  
<http://www.tsoshop.co.uk>

### UNITED STATES and CANADA/ ÉTATS-UNIS et CANADA

Manhattan Publishing Co  
2036 Albany Post Road  
USA-10520 CROTON ON HUDSON, NY  
Tel.: +1 914 271 5194  
Fax: +1 914 271 5886  
E-mail: [coe@manhattanpublishing.coe](mailto:coe@manhattanpublishing.coe)  
<http://www.manhattanpublishing.com>

Council of Europe Publishing/Éditions du Conseil de l'Europe

FR-67075 STRASBOURG Cedex

Tel.: +33 (0)3 88 41 25 81 – Fax: +33 (0)3 88 41 39 10 – E-mail: [publishing@coe.int](mailto:publishing@coe.int) – Website: <http://book.coe.int>

Arsimi luan një rol qendror në zhvillimin dhe përhapjen e vlerave themelore të Këshillit të Europës që janë: demokracia, të drejtat e njeriut dhe shteti i së drejtës, si dhe parandalimi i shkeljeve të të drejtave të njeriut. Në këtë drejtim, arsimi po shihet gjithnjë e më shumë si një instrument mbrojtës kundrejt rritjes së dhunës, racizmit, ekstremizmit, ksenofobisë, diskriminimit dhe intolerancës. Ky qëndrim gjithnjë e më i vetëdijshëm ndaj arsimit pasqyrohet në miratimin e Kartës së Këshillit të Europës për edukimin për qytetari demokratike dhe për të drejtat e njeriut nga 47 shtetet anëtare të Organizatës, në kuadrin e Rekomandimit CM/Rec (2010)7.

Karta është rezultat i konsultave të gjera disavjeçare. Ndonëse nuk ka karakter detyrues, ajo është një pikë e rëndësishme referimi për të gjithë ata që merren me edukimin për qytetari dhe për të drejtat e njeriut. Zbatimi i saj do të nxisë shtetet anëtare të marrin masa në këtë fushë, dhe në këtë mënyrë, të përhapin praktikat e qytetarisë demokratike dhe të përmirësojnë cilësinë e edukimit të saj në Europë e më gjerë.



[www.coe.int](http://www.coe.int)

Këshilli i Europës përbëhet nga 47 shtete dhe mbulon afërsisht të gjithë kontinentin Europian. Qëllimi i tij kryesor është të zhvillojë në të gjithë Europën parimet e përbashkëta demokratike e ligjore të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut dhe të dokumenteve të tjera për mbrojtjen e individëve që lidhen me të. Që me krijimin e tij në vitin 1949, pas Luftës së Dytë Botërore, Këshilli i Europës ka simbolizuar ripajtimin.

ISBN 978-92-871-6898-6



€8/US\$<http://book.coe.int>  
Council of  
Europe  
Publishing